



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2810 Prot.

Lezhë, më 03.03. 2022

VENDIM

Nr. 16 Datë 28.02.2022

PËR

**DISA SHTESA E NDRYSHIME NË VKB NR.157, DATË 17.11.2021 "PËR
MIRATIMIN E NIVELIT TË TAKSAVE, TARIFAVE VENDORE PËR SHËRBIMET
PUBLIKE DHE ATO ADMINISTRATIVE, LEHTËSIRAT FISKALE, STRUKTURAT
E VJELJES SË TYRE DHE ATO TË VENDOSJES SË PENALITETEVE NDAJ
KUNDRAVAJTËSVE"**

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 9, pika 1/1.3, gërma "b", neni 35, pika 4, neni 54, gërma "f", Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", të ndryshuar, neni 5, gërma "b", neni 22, pika 4, në VKM, nr.132, datë 07.03.2018, neni 2, pika 2.1., në Ligjin nr.9920 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;


VENDOSI

1. Të bëjë shtesat dhe ndryshimet në pikën "A.2.a.Taksa mbi Ndërtesën", pika "A.2.a.6.", "Në rastet e mungesës ose mos paraqitjes së dokumentacionit për pronësinë mbi ndërtesat", pika "a.", e cila ishte me tekstin "*Kategoria "Familjarë", që kanë kontratë me Drejtorinë e Ujësjellës-Kanalizime Sh.A.Lezhë, kanë detyrimin të dërgojnë tek ky Institucion çertifikatën e pronësisë së banesës, mbi bazën e të cilës do bëhet faturimi për taksën mbi ndërtesën. Në rast të mosparaqitjes së dokumentacionit të sipërcituar, atëherë do faturohet për një sipërfaqe banese prej 100 m², për çdo kryefamiljar, që ka kontratë me Drejtorinë e Ujësjellës-Kanalizime Sh.A.Lezhë*", fjalia e dytë në këtë pikë, ndryshohet me përmbajtjen dhe tekstin si më poshtë :
 - a. Në rast të mungesës apo mos paraqitjes së dokumentacionit për pronësinë mbi ndërtesat, sipërfaqja prezumohet 100 (njëqind) m², për ndërtesat për banim dhe 70 (shtatëdhjetë) m² për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar.
2. Të bëjë shtesë në pikën "B.3. Tarifa e Parkimit të Automjeteve", në kategorinë 2.2.e. me përshkrimin, tekstin dhe nivelin e tarifës si më poshtë :

Nr	Kategoria	Njësia	Niveli i Tarifës
2.2.e.	Abone mujore, për banorët rezidentë në ndërtesat e reja të ndërtuara me rastin e fatkeqësive të tërmetit	Lekë / muaj	3.000

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI
ERNEST RAKAJ**

